

Projektet është financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni. Informacionet dhe qëndrimet e publikuara nuk i pasqyrojnë qëndrimet zyrtare të Fondacionit Shoqëria e Hapur – Maqedoni


KONKLUZIONE NGA RAPORTI I PARË I MONITORIMIT “NGA PRIBE 1 DERI TEK PRIBE 2 DHE MË PAS” (PERIUDHA 1.7.2015 – 30.9.2017)

Projekti: “Aksion i përbashkët për reforma urgjente në gjyqësor”

1. depolitizimi i zgjedhjes dhe avancimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë në praktikë, dhe jo vetëm në teori, në bazë të kriterëve transparente dhe objektive dhe kriterëve të bazuara në merita:

2. zbatimi i sistemit të harmonizuar sipas punës, bazuar në standarde kuantitative, por edhe kualitative, si bazë për avancimin në karrierë në gjyqësor dhe në prokurorinë publike:

- Këshilli Gjyqësor merr vendime me të cilat e përcakton numrin e përafërt të lëndëve të cilat gjyqtari duhet t’i zgjidh në nivel mujor edhe atë në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, por nuk ka miratuar Rregullore me të cilën e përcakton metodologjinë e kompleksitetit të materies të cilës i përket lënda gjatë përcaktimit të numrit të përafërt të lëndëve të cilat gjyqtari duhet t’i zgjidh në nivel mujor;
- Në mbledhjen e datës 3.7.2017, për herë të parë kishte diskutim thelbësor lidhur me kandidatët e propozuar për kryetar të gjykatës dhe për programet e propozuara për punën e tyre;
- Nga shtatori i vitit 2016, Këshilli Gjyqësor publikoi vendime të arsyetuara për kandidatët e zgjedhur për gjyqtarë ose kryetarë të gjykatës, por jo edhe për kandidatët të cilët nuk janë zgjedhur;
- Nuk ka iniciativa nga Këshilli Gjyqësor për avancimin e akteve normative, në lidhje me përmirësimin e kriterëve kualitative për vlerësimin e kryerjes së funksionit të gjyqtarit, ndërkaq të cilët janë vetëm 3 në numër;
- Pas zbatimit të kriterëve të reja për zgjedhjen e gjyqtarëve porotë nga data 1.1.2016, ndërsa kompensimi për punën e tyre është vetëm 250 denarë në ditë, numri i vogël i gjyqtarëve-porotë nëpër gjykata nga dita në ditë shënon rënie, ndërsa kjo ka impakt negativ mbi efektin e punës, veçanërisht tek gjykatat themelore;
- Në këtë periudhë u bë zgjedhja e 3 prokurorëve publikë në Prokurorinë Publike të RM-së, 4 në prokuroritë e larta publike dhe 15 në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit. U shkarkuan gjithsej 21 prokurorë publikë, ndërsa nuk ka prokurorë të shkarkuar publikë sipas procedurës së zbatuar për përcaktimin e përgjegjësisë për shkelje të kryer më të rëndë disiplinore;
- Janë paraqitur 186 parashtrësia dhe ankesa nga qytetarë dhe persona juridikë në lidhje me punën e prokurorëve publikë, por në asnjërën prej tyre nuk është konstatuar bazë për dyshime;
- Ligji për Këshillin e Prokurorëve Publikë nuk përmban ndonjë dispozitë precize, ndërsa në të vërtetë seancat e Këshillit janë të mbyllura për publikun. Këshilli ka ueb-faqe të vet e cila azhurnohet me një intensitet më të dobët, meqë në shërbimin e tyre nuk ka person të punësuar si teknik i teknologjisë së informacionit;



- Ish kryetari i Këshillit e ushtroi funksionin edhe një mandat, edhe pse nuk kishte bazë ligjore për të njëjtën, ndërsa në datën 31.8.2017, u zgjedh kryetar i ri i Këshillit;

3. të evitohen elementet nga sistemi për përgjegjësi disiplinore dhe për shkarkimin e gjyqtarëve të cilët për momentin e rrënojnë pavarësinë gjyqësore si në teori ashtu edhe në praktikë;

- Pas miratimit të aktgjykimeve të GJEDNJ “Mitrinovski kundër RM”, Këshilli gjyqësor, me Rregulloren e punës, për herë të parë e riprecizoi procedurën për përsëritjen e procedurës para këtij organi, sipas aktgjykimit të miratuar nga GJEDNJ, i cili në shumë aspekte është diskutabil, duke e pasur parasysh statusin, funksionin dhe kompetencat e Këshillit Gjyqësor;
- Këshilli për Përcaktimin e Fakteve paraqiti 6 kërkesa deri te Këshilli Gjyqësor për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit për shkak të kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit. Këshilli Gjyqësor vetëm për një kërkesë ka miratuar vendim për hedhjen poshtë të kërkesës si jo të plotë, ndërsa sa u përket kërkesave të tjera procedurat janë akoma në rrjedhë e sipër dhe të njëjtat janë të mbyllura për publikun (konform Ligjit);
- Këshilli për Përcaktimin e Fakteve ngriti kallëzim penal kundër kryetarit të Gjykatës Supreme të RM-së;

4. sigurimi i profesionalizmit të Këshillit Gjyqësor në praktikë, dhe jo vetëm në teori, (përkatësisht test i qartë dhe i parashikueshëm për zbatimin e kriterit “jurist i shquar”):

- Në dy zgjedhjet e fundit të anëtarit të Këshillit Gjyqësor nga radhët e juristëve të shquar është respektuar kriteri kandidati të ketë 15 vjet përvojë pune si jurist, megjithatë kushtet e tjera të parashikuara në ndryshimet e fundit ligjore nuk janë marrë në konsideratë, më saktësisht, nga biografite e tyre nuk mund të fitohet përshtypje se a janë plotësuar të gjitha elementet për “juristë të shquar”. Veçanërisht joserioze ishte zgjedhja e anëtarit të Këshillit Gjyqësor për një mandat prej 6 vitesh të cilit në kohën e zgjedhjes, i mbesin edhe 3 muaj për përmbushjen e kushteve për pension pleqërie;
- Në Raportin e Pribe-s të muajit shtator 2017, rekomandohet që anëtarët e KGJRM nga radhët e “juristëve të shquar” të përzgjidhen nga juristët e fakulteteve ose nga sektori civil, ose me 2/3 e shumicës në Kuvendin e RM-së. Në Raport, mes tjerash, rekomandohet të bëhet kontroll i jashtëm mbi sistemin AKMIS në lidhje me shpërndarjen e lëndëve gjyqësore tek gjyqtarët;
- Në raportin e Pribe-s nga shtatori i vitit 2017 rekomandohet që pjesa e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, të cilët nuk janë zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve, të zgjidhen në mënyrë jo politike, për shembull, përmes votimit të drejtpërdrejtë nga juristët ose nga fakultetet juridike ose përmes votimit me 2/3 e shumicës në Kuvend, me mekanizëm të parashikuar për pengimin e bllokimit eventual të procesit, nëse nuk është siguruar shumicë, si dhe të kërkohet këshillë nga Komisioni i Venecias. Veç tjerash, në Raport theksohet nevoja të zbatohet një revizion i plotë dhe i pavarur ndaj funksionimit të sistemit për shpërndarjen e rastësishme të lëndëve (AKMIS), me qëllim që të përcaktohet nëse dhe nga kush është keqpërdorur ky sistem. Për këtë qëllim, kah fundi i muajit shtator të vitit 2017, u formua komisioni i jashtëm;

5. sigurimi i rolit proaktiv të Këshillit Gjyqësor dhe të gjykatave më të larta në mbrojtje të pavarësisë së tyre dhe në mbrojtje nga ndikimet (si përmes strategjisë së përmirësuar të komunikimit, ashtu edhe përmes aksioneve vendimmarrëse për reagimin e ndikimeve ose presioneve):

- Nga muaji shtator i vitit 2016 u rrit prezenca e kryetarit të Këshillit Gjyqësor në media edhe atë përmes pjesëmarrjes në disa emisione televizive, ndërkaq sa u përket disa ngjarjeve në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup, shënuan rritje edhe komunikatat publike, si dhe dhënia e deklaratave për media nga ana e kryetarit të Gjykatës në lidhje me ngjarjet. Edhe pse

ngjarje të këtilla ekzistonin edhe në të kaluarën, në shtator të vitit 2016 u organizua një pres-konferencë (e vetme deri më tani), për shkak të thirrjes në seancë dëgjimore në cilësinë e personave të pandehur të pesë gjyqtarëve nga Gjykata Administrative nga ana e Prokurorisë Speciale Publike;

- Mbledhjet e Këshillit Gjyqësor janë të hapura për publikun çdoherë kur një gjë të këtillë e mundëson ligji, megjithatë, për shumicën e pikave të rendit të ditës, nuk kishte debat esencial. Nga mbledhja e mbajtur më datë 3.7.2017 dukshëm shënoi rritje debati esencial edhe për pikat e rendit të ditës në lidhje me zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave;
- Është evident mosrespektimi i (disa) anëtarëve të Këshillit Gjyqësor sa u përket parimeve për sjellje etike nga Kodeksi i Etikës, dhe veçanërisht parimi i përgjegjësisë morale, me çka ndikojnë negativisht mbi perceptimin objektiv dhe mbi përforcimin e besimit ndaj gjyqësorit;
- Këshilli i Fakteve nuk ka faqe të vet për shkak se Këshilli Buxhetor Gjyqësor nuk ka realizuar prokurim përkatës për të njëjtin. Megjithatë, Këshilli i Fakteve rregullisht i paraqet raportet për punën e vet përmes postës elektronike deri te mediat dhe deri te IDNJ;

6. Të avancohet cilësia e trajnimit, buxhetit dhe autonomisë së Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë (dhe të stimulohet referimi i gjyqtarëve nacional për stazh në GJEDNJ):

- Ndryshimet e deritanishme të Ligjit për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë u miratuan pa ndonjë debat të gjerë publik dhe në procedurë të shkurtuar, e që kontribuon për disa mangësi të caktuara ligjore;
- Me ndryshimet e fundit të Ligjit, nga muaji dhjetor i vitit 2015, u paraqit diskrapancë sa u përket kushteve për zgjedhje të trajnimit fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, meqë kriteret e veçanta për zgjedhjen e prokurorëve publikë ishin dedikuar vetëm për plotësimin e vendeve deficitare. Në përputhje me Raportin e KE-së për Maqedoninë, zgjidhja e këtillë kontribuon për disbalancë midis zgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë;
- Pamundësia aktuale për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë nga radhët e juristëve të cilët kanë përvojë pune të gjatë në avokati, bashkëpunëtorët ekzistues profesionistë me përvojë nëpër gjykata, nga profesorët universitarë, nga ish-gjyqtarët në GJEDNJ dhe nga përfaqësuesit me profesione të tjera juridike (përveç përmes Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, si dhe nga kandidatët me përvojë të vogël pune pas provimit të dhënë të jurisprudencës) lë hapësirë për dyshime dhe diskutime. Zgjedhja e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë vetëm përmes Akademisë është vlerësuar pozitivisht në raportet ndërkombëtare;
- Dhënia elektronike e pjesës praktike të provimit përfundimtar lë hapësirë për dyshime nëse e arrin qëllimin për vlerësimin e aftësive praktike të dëgjuesve për zgjidhjen e studimeve të rastit;
- Akademia financohet nga buxheti i RM-së i dedikuar për pushtetin gjyqësor, si dhe nga donatorë të huaj. Në krahasim me vitin 2015, Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë për vitin 2017 ka buxhet të rritur dhe nuk guxohet të lejohet, si në vitet e kaluara, përmes rishikimit të buxhetit këto mjete të shkurtohen. Është indikativ edhe fakti nëse buxheti i këtillë është i mjaftueshëm duke e pasur parasysh atë se një pjesë e trajnimeve të Akademisë realizohen me ndihmën e donatorëve të huaj;
- Akademia punon në mënyrë transparente sa i përket publikimit të të dhënave më të rëndësishme të ueb-faqes. Në raportet vjetore, në mënyrë të detajuar janë përshkruar të gjitha aktivitetet e Akademisë, financimi, si dhe statistika. Katalogët publikohen rregullisht dhe janë të aksesshëm në ueb-faqen. Jofunksionale është pjesa e ueb-faqes në të cilën janë

publikuar rank-listat përfundimtare të provimit të kryer dhe listat e dëgjuesve të pranuar. Mungon publikimi i biografive të trajnuesve të angazhuar për trajnimet e realizuara;

- Akademia ka marr pjesë me sukses në shumë konferenca dhe trajnime, në mënyrë që të shqyrtohen praktikat dhe mundësitë më të mira për implementimin e tyre, me qëllim të funksionimit dhe avancimit më të mirë të sistemit të jurisprudencës;
- Në pjesën e trajnimit fillestar mungojnë trajnime për përmbushjen e kriterëve të shteteve-kandidate për anëtarësim në BE, me theks të veçantë mbi Kapitullin 23 dhe 24, si më relevantë për jurisprudencën dhe për negociatat para-aderuese. Zbatohet evaluimi i rregullt i trajnimeve, ndërsa të dhënat nga evaluimi janë prezantuar në Raportin vjetor për vitin 2015. Të dhënat e këtilla nuk janë përfshirë me Raportin vjetor të vitit 2016;
- Në pjesën më të madhe ndiqen ndryshimet ligjore dhe nevojat gjatë realizimit të trajnimit të vazhdueshëm, ndërsa nuk i është përkushtuar vëmendje e mjaftueshme trajnimeve për zgjidhjen alternative të kontesteve. Nevoja e këtillë është theksuar edhe në Draft-strategjinë për reforma në sektorin e jurisprudencës;
- I pamjaftueshëm është numri i trajnimeve për komunikime, me qëllim të përforcimit të transparencës së gjyqësorit. Këto trajnime janë më se të nevojshme për personat përgjegjës për marrëdhënie me publikun, ndërsa më së shumti kanë të bëjnë me komunikimet me mediat, me gazetarët, organizatat qytetare dhe me publikimin e informacioneve të ndryshme në internet me interes për publikun e gjerë;
- Akademia ka vendosur bashkëpunim me organizatat qytetare dhe me institucionet e tjera, si në pjesën e përfshirjes së trajnimeve, ashtu edhe në pjesën e përfshirjes së propozimeve të tyre në programin e përgjithshëm për program të vazhdueshëm për vitin 2017-2018. Nevojitet që ky proces të jetë gjithnjë e më inkluziv;

7. Të sigurohet publikimi i të gjitha aktgjyqësoreve gjyqësore me afate të qarta të përcaktuara me ligj (dhe të sigurohen mundësi të plota për kërkim dhe për akses më të lehtë):

- I pamjaftueshëm është funksionaliteti i portalit www.sud.mk, si dhe promovimi i tij. Shqetëson fakti se një pjesë më e madhe e publikut profesionist nuk është i kënaqur me funksionimin e portalit, me azhurnimin e tij të parregullt, si dhe me nivelin e pamjaftueshëm që ky portal të jetë burim i praktikës gjyqësore dhe informator për punën e gjyqësorit;
- Përmbushja e prioritetit e imponon publikimin e vendimeve (shqiptimeve) në afatet e parashikuara me ligj. Është alarmante se 55% e të anketuarve – avokatë kanë theksuar se gjykatat vetëm ndonjëherë ose asnjëherë nuk i publikojnë vendimet gjyqësore në afatet ligjore. Konform sondazhit, nuk respektohen as afatet ligjore për përpilimin e vendimeve ligjore;
- Janë problematike dispozitat e Udhëzimit për mënyrën e publikimit dhe për kërkimin e vendimeve gjyqësore në ueb-faqen e gjykatës, organet e administratës shtetërore dhe institucionet publike sa i përket anonimizimit të tyre, madje edhe në rastet kur nuk bëhet fjalë për sekret shtetëror;
- Mungojnë dispozita në Rregulloren gjyqësore për publikimin e të dhënave të detyrueshme në portalet gjyqësore, siç është publikimi i të dhënave për punën financiare të gjykatave dhe publikimi edhe nga Raporti vjetor financiar;

8. Të përpilohet dosje për kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave gjyqësore me fokus të veçantë mbi “lëndë të vjetra”:

- Numër më të madh të lëndëve, të cilat janë më të vjetra se 7 dhe 10 vjet, ka në Gjykatën Themelore Shkup 2 Shkup, Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup dhe Gjykatën Themelore Kumanovë.

- Gjykata Themelore Shkup 2 Shkup ka 123 lëndë më të vjetra se 7 vjet dhe 42 lëndë më të vjetra se 10 vjet;
 - Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup ka 81 lëndë më të vjetra se 7 vjet dhe 31 lëndë më të vjetra se 10 vjet;
 - Gjykata Themelore Kumanovë ka 7 lëndë më të vjetra se 7 vjet dhe 7 lëndë më të vjetra se 10 vjet.
- Numër më të madh të lëndëve për të cilat është paraqitur kërkesë për mbrojtjen e të drejtës së gjyqimit në afat të arsyeshëm dhe është përcaktuar shkelje e të drejtës nga ana e Gjykatës Supreme, ka të bëjë me lëndët para Gjykatës Themelore Shkup 2 Shkup, Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup dhe Gjykatës Themelore Kumanovë.
- Për lëndët para Gjykatës Themelore Shkup 2 Shkup janë paraqitur 323 kërkesa, ndërsa është përcaktuar shkelje për gjykim në afat të arsyeshëm në 100 lëndë;
 - Për lëndët para Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup janë paraqitur 105 kërkesa, ndërsa është përcaktuar shkelje për gjykim në afat të arsyeshëm në 38 lëndë;
 - Për lëndët para Gjykatës Themelore Kumanovë janë paraqitur 160 kërkesa, ndërsa është përcaktuar shkelje për gjykim në afat të arsyeshëm në 23 lëndë.
- Probleme dhe shkaqe të cilat rezultojnë me zvarritje të procedurave, sipas perceptimit të avokatëve janë:
- tendenca që gjykatat e shkallëve të dyta t'i shfuqizojnë aktgjykimet dhe lëndët t'i kthejnë në gjykim të sërishëm para gjykatës së shkallës së parë;
 - përcaktimi jo i plotë i gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë;
 - tejkalimi i afateve gjatë miratimit të vendimeve nga gjykatat e shkallës së dytë;
 - dërgesa e parregullta;
 - periudha e gjatë kohore midis seancave gjyqësore;
 - vëllimi i madh i lëndëve në gjykata të caktuara;
- 9. Të sigurohet ekzekutimi i shpejtë i të gjitha aktgjykimeve të GJEDNJ kundër shtetit, veçanërisht përmes instalimit të masave praktike dhe efikase për çdo kategori të rasteve:**
- Në periudhën kohore, nga muaji korrik 2015 deri në qershor të vitit 2017, është konstatuar shkelje e të drejtave të garantuara me GJEDNJ në 15 lëndë kundër RM-së. Në periudhën kohore, nga muaji korrik i vitit 2017 deri në shtator të vitit 2017, është konstatuar shkelje e të drejtave të garantuara me GJEDNJ në 3 lëndë kundër RM-së;
 - Në një pjesë të lëndëve afatet për paraqitjen e Plan Veprimit, përkatësisht Raportit nga Byroja për Përfaqësimin e RM-së para GJEDNJ anashkalohen. Si rrethana rënduese mund të theksohen mbajtja jo e rregullt e mbledhjeve të Komisionit Ndërsektorial për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ, vëllimi i rritur i punës, përkundrejt kapaciteteve të reduktuara të Byrosë për përfaqësim për dy pozicione të punës nga muaji korrik i vitit 2017;
 - Lëndë të cilat janë nën mbikëqyrje të përforcuar nga Komiteti i Ministrave, përfundimisht me muajin shtator të vitit 2017 janë: El Masri kundër RM-së (39630/09), Hajrullahu kundër RM-së (37537/07), Ivanovski kundër RM-së (29908/11) dhe Karajanov kundër RM-së (2229/15);
 - Në periudhën kohore, nga qershori i vitit 2015 deri në shtator të vitit 2017, nuk ka lëndë që kanë kaluar nga monitorimi standard në monitorim të përforcuar, dhe as lëndë të cilat kanë kaluar nga monitorimi i përforcuar në monitorim standard;
 - Në periudhën kohore, nga korriku deri në shtator të vitit 2017, Komisioni Ndërsektorial nuk ka mbajtur seanca. Në vitin 2015 Komisioni Ndërsektorial ka mbajtur 4 mbledhje, dhe pastaj në mënyrë konstante numri i mbledhjeve të mbajtura shënon rënie, kështu që në vitin 2016 është mbajtur vetëm 1 mbledhje e këtij trupi.